

KONCESIONE / PARTNERITET **PUBLIK PRIVAT**

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË **NJOFTIM FITUESI**

Për: Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “SALILLARI” sh.p.k. / NUIS J62903125G, “ALB TIEFBAU” sh.p.k. / NUIS J66703049C, “InfraKonsult” sh.p.k. / NUIS L21512022F dhe “ERALD-G” sh.p.k. / NUIS K36306784K me adresë: Lagjia 4 Shtatori, Nr. Pasurie 1/28, Zona Kadastrale Nr.3682, Ura Vajgurore Dimal (ish Magazinat), përballë Komisariatit të Policisë Ura Vajgurore, Bashkia Dimal, Berat.

Procedura konkurruese: Dhënia me koncesion/partneritet publik privat për projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor Milot - Balldre.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Projektim, financim, ndërtim, operim, mirëmbajtje, rehabilitim dhe transferim i segmentit rrugor Milot - Balldre, ku gjurma e kësaj rruge fillon në pikën fundore të aksit Thumanë-Milot, pas nyjes ekzistuese të Milotit, zhvillohet tërësisht në një gjurmë të re rrugore dhe përfundon rreth 1.0 km nga kryqezimi i fshatit Balldren. Kohëzgjatja e kontratës së koncesionit/PPP: 35 vjet

Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 44 datë 18.08.2025

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këto ofertues me ofertat përkatëse të ofruara:

- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “4 A-M” sh.p.k. / NUIS K92005016L, “YÛKSEL INŞAAT ANONİM ŞİRKETİ” / NUIS 0995000769500001, “SEED CONSULTING” sh.p.k. / NUIS L41824014Q, “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” sh.p.k. / NUIS K51428048I me vlerë totale të parashikuar për Kontratën 364,732,924 EUR pa TVSH;
- Shoqëria “A.N.K” sh.p.k. / NUIS J92408001N, “GJOKA KONSTRUKSION” sh.a. / NUIS J91815014U, “A&E Engineering” sh.p.k. / NUIS K72113010E, me vlerë totale të parashikuar për Kontratën 364,732,924 EUR pa TVSH;
- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “SALILLARI” sh.p.k. / NUIS J62903125G, “ALB TIEFBAU” sh.p.k. / NUIS J66703049C, “InfraKonsult” sh.p.k. / NUIS L21512022F, “ERALD-G” sh.p.k. / NUIS K36306784K, me vlerë totale të parashikuar për Kontratën 364,732,924.00 EUR pa TVSH ;

Janë s'kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "4 A-M" sh.p.k., "YÜKSEL İNŞAAT ANONİM ŞİRKETİ", "SEED CONSULTING" sh.p.k., "TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING" sh.p.k.;
2. Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "A.N.K" sh.p.k., "GJOKA KONSTRUKSION" sh.a, "A&E Engineering" sh.p.k.;

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "4 A-M" sh.p.k., "YÜKSEL İNŞAAT ANONİM ŞİRKETİ", "SEED CONSULTING" sh.p.k., "TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING" sh.p.k., i krijuar nëpërmjet Kontratës së Bashkëpunimit të Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, Nr. repertori 5391, dhe Nr. koleksioni 1662, datë 08.10.2025, me shoqërinë "4 A-M" sh.p.k. në cilësinë e përfaqësuesit, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. Ardit Metaliaj, në bazë të Prokurës së Posaçme Nr. repertori 5393 dhe Nr. koleksioni 1663, datë 08.10.2025, nuk është kualifikuar pasi nuk ka paraqitur Sigurimin e Zgjatur të Ofertës, në kundërshtim me kërkesat e nënpikës 3.2.2 të pikës 3 "Oferta: Përgatitja" të Dokumenteve Standarde të Koncesionit (DSK), sipas së cilës mos shtyrja e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës përbën shkak për skualifikimin e Ofertuesit.
- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "A.N.K" sh.p.k., "GJOKA KONSTRUKSION" sh.a dhe "A&E Engineering" sh.p.k., i krijuar nëpërmjet Akt Marrëveshjes, Kontratë e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive Nr. repertori 10811 dhe Nr. koleksioni 2277, datë 10.10.2025, me shoqërinë "A.N.K" sh.p.k. në cilësinë e përfaqësuesit, përfaqësuar nga administratori z. Agim Kola, në bazë të Prokurës së Posaçme Nr. repertori 10812 dhe Nr. koleksioni 2278, datë 10.10.2025, si dhe Prokurës së Posaçme Nr. repertori 10813 dhe Nr. Koleksioni 2279, datë 10.10.2025, nuk është kualifikuar pasi oferta e tij nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar dhe nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Shtojcën nr. 9 të DSK-së. Ky operator ekonomik nuk kualifikohet, për arsyet si më poshtë:

1. Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "A.N.K" sh.p.k., "Gjoka Konstruksion" sh.a dhe "A&E Engineering" sh.p.k., nuk përmbush kriterin kualifikues "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", pasi dokumentacioni ekonomik-financiar i paraqitur nuk siguron përputhshmëri të plotë me kërkesat e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, të cilat kanë qenë të përcaktuara qartë, dhe në kuadër të zhvillimit të procedurës, janë shpjeguar më tej përmes përgjigjeve të pyetjeve sqaruese të publikuara në sistemin elektronik të APP-së.

2. Shoqëria "A.N.K" sh.p.k., anëtare e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, nuk ka përmbushur kërkesat minimale për kapitalet e veta në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së deklaruar në bashkim, në kundërshtim me kërkesat e Dokumenteve të Procedurës Konkurruese, sipas të cilave treguesit ekonomikë dhe financiarë duhet të përmbushen nga i gjithë grupi sipas përqindjes dhe natyrës së pjesëmarrjes së secilit anëtar në realizimin e kontratës.

3. Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive "A.N.K" sh.p.k., "Gjoka Konstruksion" sh.a dhe "A&E Engineering" sh.p.k., nuk ka paraqitur një Plan Biznesi në përputhje me Formularin e Ofertës, pasi në dokumentacionin e dorëzuar konstatohet mospërputhje lidhur me afatin e ndërtimit dhe elementë të tjerë thelbësorë të ofertës. Konkretisht, në Formularin e Ofertës është deklaruar periudha e

ndërtimit 15 (pesëmbëdhjetë) muaj, ndërsa në Planin e Biznesit janë paraqitur afate kontradiktore prej 22 (njëzet e dy) muajsh dhe 15 (pesëmbëdhjetë) muajsh. Gjithashtu, në Formularin e Ofertës është deklaruar se garancia nga shteti është zero, ndërkohë që në Planin e Biznesit janë paraqitur tabela me vlera përkatëse për garanci nga shteti, duke krijuar pasiguri dhe mungesë koherence në elementët thelbësorë të ofertës.

4.Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “A.N.K” sh.p.k., “Gjoka Konstruksion” sh.a. dhe “A&E Engineering” sh.p.k., nuk përmbush kriterin kualifikues “Eksperienca në Projektim”, pasi nuk ka provuar disponimin e ekspertit me profilin dhe kualifikimin specifik “Inxhinier Gjeoteknik”, sipas kërkesave të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese. Konkretisht anëtari i Bashkimit të Përkohshëm të shoqërive, shoqëria “A&E Engineering” sh.p.k., ka deklaruar në stafin drejtues teknik z. Vladimir Avda në cilësinë e inxhinierit gjeoteknik. Ndërkohë që nga dokumentacioni i depozituar nga ky anëtar i bashkimit të përkohshëm të shoqërive, rezulton se z. Vladimir Avda është i pajisur me licencë në projektim me titull “Gjeolog”, zotëron diplomë në degën “Gjeologji Miniera” dhe është i punësuar pranë shoqërisë “A&E Engineering” sh.p.k. në pozicionin “Drejtues Teknik - Inxhinier Gjeolog”. Për rrjedhojë, nuk është provuar përmbushja e kërkesës për ekspert “Inxhinier Gjeoteknik”.

5.Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “A.N.K” sh.p.k., “Gjoka Konstruksion” sh.a. dhe “A&E Engineering” sh.p.k., nuk përmbush kriterin kualifikues “Eksperienca në Ndërtim”, pasi asnjë nga anëtarët e deklaruar si përgjegjës për ndërtimin, konkretisht shoqëritë “A.N.K” sh.p.k. dhe “Gjoka Konstruksion” sh.a., nuk kanë paraqitur personelin mbështetës të kërkuar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese. Konkretisht nuk kanë paraqitur 1 (një) Inxhinier Ndërtimi me profil “Infrastrukturë e Transportit”, sipas kërkesave të përcaktuara në Dokumentet e Procedurës Konkurruese.

6.Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “A.N.K” sh.p.k., “Gjoka Konstruksion” sh.a. dhe “A&E Engineering” sh.p.k., nuk ka paraqitur një ndarje të plotë dhe të qartë të përgjegjësiave për realizimin e punimeve të ndërtimit, pasi në Tabelën nr. 1, pjesë përbërëse Akt-Marrëveshjes (Kontratë Bashkëpunimi) nr. 10811 Rep. dhe nr. 2277 Kol., datë 10.10.2025, të lidhur ndërmjet palëve, rezulton se për zërin “Ndërtimi i tunelit dhe sinjalistikës përkatëse”, shoqëria “A.N.K” sh.p.k. është angazhuar për 0.01% të punimeve dhe shoqëria “Gjoka Konstruksion” sh.a. për 19.99% të tyre, duke mos rezultuar mbulimi i plotë në masën 100% i këtij zëri punimesh nga anëtarët e deklaruar si përgjegjës për realizimin e ndërtimit.

Ndërsa, është kualifikuar:

- Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “Salillari” sh.p.k., “ALB TIEFBAU” sh.p.k., “InfraKonsult” sh.p.k., “ERALD-G” sh.p.k., me 93 pikë nga 100 pikë të mundshme.

* * *

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive “SALILLARI” sh.p.k / NUIS J62903125G, “ALB TIEFBAU” sh.p.k. / NUIS J66703049C, “InfraKonsult” sh.p.k / NUIS L21512022F dhe “ERALD-G” sh.p.k / NUIS K36306784K, me adresë: Lagjia 4 Shtatori, Nr. Pasurie 1/28, Zona Kadastrale Nr.3682, Ura Vajguore Dimal (ish Magazinat), përballë Komisariatit të Policisë Ura Vajguore, Bashkia Dimal, Berat, se oferta e paraqitur më datë 13 Tetor 2025, për marrjen me koncesion/PPP projektimin, financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor Milot-Balldre, është pranuar.

Afati i negocimit të Kontratës tuaj do të jetë 60 ditë nga marrja e njoftimit të fituesit.

Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “SALILLARI” sh.p.k / NUIS J62903125G, “ALB TIEFBAU” sh.p.k. / NUIS J66703049C, “InfraKonsult” sh.p.k / NUIS L21512022F dhe “ERALD-G” sh.p.k / NUIS K36306784K, kërkohet t’i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dokumentet e mëposhtme:

- Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare\Partneritetit Publik Privat, të nënshkruar.
- Sigurimin e Kontratës sipas formës së kërkuar në Dokumentat e Procedurës Konkurruese, në vlerën e 5% e vlerës së ndërtimit. Sigurimi duhet të paraqitet para nënshkrimit të Kontratës nga të dy palët.
- Dokument që vërteton pagesën e vlerës së tarifës së ATRAKO-s, referuar nenit 12 të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” të ndryshuar.
- Ofertën origjinale të shtypur/printuar ose të shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi me të drejtë nënshkrimi (i autorizuar me prokurë) duhet të nënshkruajë Ofertën duke nënshkruar origjinalin e ofertës; dhe firmosur në secilën faqe të origjinalit të dokumentave që shoqërojnë ofertën ekonomike.
- Në rast se tërhiqeni nga lidhja e kontratës duhet të njoftoni me shkrim.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05.06.2026

Ankesa: Nuk ka